

VENDIM
Nr. 651, datë 13.8.2020

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS FINANCIARE, SI PASOJË E COVID-19, PËR TË PUNËSUARIT APO ISH-TË PUNËSUARIT NË SUBJEKTET E TRANSPORTIT PUBLIK, QYTETAS DHE NDËRQYTETAS

(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1100, datë 16.12.2020)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, dhe të pikës 5, të nenit 41, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Dhënie ndihme financiare prej 26 000 (njëzet e gjashtë mijë) lekësh, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, për të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet e transportit publik, qytetas dhe ndërqytetas.

1/1. Dhënie ndihme financiare prej 10 000 lekësh për të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet e transportit publik, qytetas, ndërqytetas si dhe aktivitetin taksis.

2. E përfitojnë ndihmën, sipas pikës 1 të këtij kreu, punonjësit e deklaruar në listëpagesat e subjekteve si më sipër, pavarësisht nëse kanë përfituar ose jo nga paketat e mëparshme të ndihmës financiare, të dhënë për këtë qëllim.

2/2. E përfitojnë ndihmën financiare sipas pikës 1/1, të këtij kreu, të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet sipas kësaj pike, të cilët kanë përfituar nga paketat e mëparshme të ndihmës financiare apo ky vendim, si edhe ata të cilët nuk kanë përfituar nga paketat e mëparshme të ndihmës financiare apo ky vendim, me kushtin që të figurojnë në listëpagesat e muajit shtator 2020.

2/3. Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës financiare:

a) individët e punësuar, të cilët kanë realizuar për vitin 2019 të ardhura bruto nga paga mbi 2 000 000 (dy milionë) lekë;

b) punonjësit e institucioneve shtetërore;

c) të punësuarit në shoqëritë me kapital shtetëror.

II. KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS FINANCIARE

1. Ndihma financiare llogaritet dhe jepet për të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet e transportit publik, qytetas, ndërqytetas, që figurojnë në listëpagesat e deklaruara për periudhën tatimore shkurt 2020, të cilat janë dorëzuar pranë administratës tatimore deri në datën 12.8.2020.

1/1. Ndihma financiare, sipas pikës 1/1, të kreut I, llogaritet dhe jepet për të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet e transportit publik, qytetas, ndërqytetas si dhe aktivitetin taksis, të cilët kanë përfituar nga paketat e mëparshme të ndihmës financiare apo ky vendim.

1/2. Për të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet e transportit publik, qytetas, ndërqytetas si dhe aktivitetin taksis, të cilët nuk kanë përfituar nga paketat e mëparshme të ndihmës financiare apo ky vendim, ndihma financiare llogaritet dhe jepet për punonjësit apo ish-punonjësit që figurojnë në listëpagesat e muajit shtator 2020.

2. Për punonjësit, të cilët kanë përfituar ndihmë financiare, sipas vendimit nr. 254, datë 27.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës së të ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19”, ose të vendimit nr. 305, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e COVID-19”, pagesa sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, do të kryhet automatikisht nga administrata tatimore, në bazë të të dhënave që kjo e fundit disponon.

3. Aplikimi për të përfituar ndihmën financiare për punonjësit apo ish-punonjësit, të cilët nuk kanë përfituar ndihmë financiare, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.254, datë 27.3.2020, ose nr.305, datë 16.4.2020, bëhet nga vetë individët. Miratimi kryhet pas verifikimit të kriterëve, bazuar në të dhënat që administrata tatimore disponon apo të dhënat që do të dorëzojnë.

4. Subjektet/individët aplikues duhet të paraqesin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nëpërmjet portalit *e-Filing*, kërkesën me të dhënat e përfituesve, ku përfshihen:

a) të dhënat identifikuese të subjektit tatimpagues të pajisur me NIUS;

b) të dhënat identifikuese të përfituesve, përfshirë:

i. emrin, mbiemrin, numrin e telefonit, adresën e *email*-it;

ii. numrin personal të identifikimit të përfituesit;

iii. bankën ku përfituesi ka llogarinë rrjedhëse bankare;

iv. IBAN-in e llogarisë bankare.

III. PROCEDURA E VERIFIKIMIT PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS FINANCIARE

1. Administrata tatimore, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e aplikimit, verifikon në sistemin tatimor, identifikon aplikuesit dhe të dhënat në kërkesën e tyre, duke analizuar:

a) tatimpaguesin dhe veprimtarinë e tij, për të verifikuar nëse bën pjesë në listën e veprimtarive që përfitojnë ndihmën financiare;

b) krahasimisht listën e paraqitur për përfitim ndihme me listëpagesën e dorëzuar në mënyrë elektronike.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i paraqet Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit listën përmbledhëse të individëve përfitues të ndihmës financiare, me të dhënat e mëposhtme:

a) emrin, mbiemrin, numrin e telefonit, adresën e *email*-it;

b) numrin personal të identifikimit të përfituesit;

c) bankën ku përfituesi ka llogarinë rrjedhëse bankare;

ç) IBAN-in e llogarisë bankare.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit kryen pagesat për individët përfitues, sipas këtij vendimi.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ruan dhe administron dokumentacionin e përcaktuar, sipas këtij vendimi, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore, të parashikuara për ruajtjen e dokumentacionit dhe arkivat.

IV. MASA E NDIHMËS FINANCIARE

1. Ndihma financiare, që përfiton i punësuar aktual, përcaktohet në kreun I të këtij vendimi.

2. Ndihma financiare për të punësuarit, në shumën e përcaktuar, përfitohet vetëm një herë si shumë e vetme.

V. ÇËSHTJE TË FUNDIT

1. Efektet financiare, në masën 245 886 000 (dyqind e dyzet e pesë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, do të përballohen nga fondi i rezervave të krijuara në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama